



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E**  
**TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2133/5 Prot.

Tiranë më 05.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 36, datë 05.12.2024**

**PËR KONTROLLUESIN “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Tirana International School” (në vijim, “Kontrolluesi ose TIS”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 157 datë 01.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit Nr. 39, datë 10.11.2023 të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale për Kontrolluesin “Tirana International School”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. “TIS” është i regjistruar me Vendim nr. 785/12, datë 18.04.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në regjistrin e OJF-ve, me NUIS K32326006U dhe ushtron aktivitet si institucion arsimor privat parauniversitar, shkollë ndërkombëtare e mesme angleze në Republikën e Shqipërisë. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve “*nxënës*”, “*prindër*”, “*punonjës*”, “*vizitorë*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 2 të Rekomandimit për përditësimin e “*Njoftimit*”. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese pranë Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, por nga analizimi i Formularit të Njoftimit është konstatuar se, “*Njoftimi*” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 5.1, të formularit të njoftimit “*Të dhëna sensitive që përpunohen*”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*” ;
- Deklarimi në rubrikën 8.1, të formularit të njoftimit “*Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale*”;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i përditësimit për ndryshimin e gjendjes së “*Njoftimit*” të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të datës 14.11.2024 të organizuar nga Zyra e Komisionerit, janë paraqitur përfaqësuesit e Kontrolluesit, ku kanë bërë me dije se kanë marrë masa për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të Rekomandimit Nr. 39, datë 10.11.2023, duke evidentuar njëkohësisht angazhimin për rikuperimin e shkeljes së konstatuar.

Në vijim, Kontrolluesi ka depozituar formularin e përditësuar të njoftimit, administruar me tonën në datën 26.11.2024.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të gremës “d” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mospërmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 21, 22, 29, 30, 39 (pika 1, gërma “d”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

4. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.

5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
6. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 05.12.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**